



# DEKRIMINALIZIMI NE SHQIPERI 2024

*Gjetje mbi sjelljen e partive dhe  
institucioneve mbi standardet e  
dekriminalizimit/integritetit*

Raport monitorimi

Instituti i Studimeve Politike (ISP)

---

*Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar KQZ dhe fushatën elektorale, si pjesë të angazhimit në projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy).*

*Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e ISP-së.*

# **DEKRIMINALIZIMI NË SHQIPËRI**

## **Raport monitorues 2024 (3)**

## Përmbajtja

Gjetjet Kryesore .....	3
Hyrje.....	4
Dekriminalizimi në nivele të larta .....	5
Dekriminalizimi në nivele të mesme dhe të ulëta.....	8
Sfidat e dekriminalizimit.....	9

## Gjetjet Kryesore

- Në vjeshtë të vitit 2024 Shqipëria pritet të hapë grupin e parë të kapitujve në procesin negociues për anëtarësim në BE. Në këtë kontekst, intensifikimi i reformave në fushën e shtetit të së drejtës, funksionimit të institucioneve demokratike dhe forcimit të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar do jetë thelbësor për ritmin e avancimit të vendit në rrugën e integritit evropian.
- I lidhur ngushtë me integrimin në BE, gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 procesi i dekriminalizimit ka vijuar të paraprihet nga progresi i bërë nga institucionet e drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Dhjetëra zyrtarë të lartë janë proceduar për vepra të reja penale, ose janë referuar në gjykatë për gjykim, duke paralajmëruar efektet pasuese të ligjit të dekriminalizimit. Gjithashtu dhjetëra individë të krimit të organizuar me lidhje informale me politikën janë goditur nga SPAK dhe ndodhen përpara drejtësisë.
- Në nivel të mesëm dhe të ulët të administratës dhe institucioneve kushtetuese janë proceduar rreth 117 individë me probleme me ligjin nga Prokuroria e Përgjithshme, 80 oficerë policie janë pezulluar ose referuar në Prokurori për shkelje administrative ose vepra penale dhe 130 individë në administratën publike në nivel qendror dhe vendor janë proceduar nga Policia e Shtetit. Një numër kaq i lartë tregon se institucionet shtetërore kanë aplikuar standarde të dobëta verifikimi paraprak dhe rekrutimi.
- Progresi i institucioneve të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta dhe krimit të organizuar është hap pozitiv në jetësimin gjithëpërfshirës të parimeve të dekriminalizimit në jetën politike dhe shtetërore të Shqipërisë. Megjithatë, procesit i kanosen disa rreziqe dhe sfida me të cilat do të duhet të përballet në vitet në vijim.
- Partitë politike dhe institucionet kushtetuese të vendit nuk kanë ndërtuar mekanizma efektivë dhe transparente parandaluese. Aktet rregullatore të miratuara mbeten shpesh vetëm në letër. Kultura klienteliste, interesat elektorale të ditës dhe sistemi i patronazhimit në promovimin politik dhe emërimin në detyra shtetërore vijnë të sfidojnë parimet e dekriminalizimit.
- Lidhjet informale me botën e krimit mbeten prezent, ndërsa ka shenja se puna e institucioneve të drejtësisë në luftën kundër kulturës së pandëshkueshmërisë në nivele të larta po has rezistencë. Ngritja e një komisioni të *posaçëm parlamentar* me objekt të paqartë dhe me fuqi për të kufizuar veprimtarinë dhe pavarësinë e institucioneve të drejtësisë qëndron si shpatë damokleu mbi kokën e parimeve të ligjit të dekriminalizimit.

## Hyrje

Në vitin 2015 Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin 138/2015 ‘*për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*’ i njohur shkurt si ligji i dekriminalizimit. Qëllimi i ligjit është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, të administratës publike nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to, apo largimit nga funksioni publik të personave, të cilët janë dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen të krimeve.<sup>1</sup> Shkak për miratimin e një ligji kaq radikal në botën demokratike u bë ekspozimi i lidhjeve të politikës shqiptare me eksponentë të krimit të organizuar dhe individëve me rekorde korruptive, të cilët depërtuan në institucionet më të larta përfaqësuese dhe kushtetuese të shtetit, përfshirë Kuvendin, të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore, në administratën publike, policinë e shtetit dhe në drejtësi.

Miratimi i ligjit pati efekte pozitive në largimin nga institucionet qendrore, veçanërisht nga Kuvendi, të individëve me të shkuar kriminale si pasojë e presionit të opinionit publik, faktorit ndërkombëtar dhe opozitës. Dhjetëra deputetë, kryetarë bashkie, si dhe qindra këshilltarë lokalë dhe punonjës të administratës publike u larguan nga funksionet shtetërore si pasojë e ligjit të dekriminalizimit.<sup>2</sup> Të gjendur nën trysninë e faktorit ndërkombëtar, medias dhe shoqërisë civile, partitë politike si institucionet kryesore përzgjedhëse dhe promovuese të funksionarëve të lartë publikë vendosën filtra verifikimi paraprak duke miratuar kode etike dhe rregullore të brendshme, që synonin pengimin e kandidimit apo promovimit në funksionet e larta publike të individëve me të shkuar kriminale. Këto masa reflektuan në vijimësi rënien graduale të numrit të kandidatëve me probleme ligjore në zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore.<sup>3</sup>

Megjithatë, krimi i organizuar dhe personat me rekorde korruptive vijuan të ndikojnë në vendimmarrjen politike në mënyrë informale duke mbështetur kandidatë të caktuar për poste publike në fushatat zgjedhore. Një pjesë e mirë e akteve vetërregulluese në partitë politike, institucionet përfaqësuese, policinë e shtetit dhe administratën publike mbetën formale dhe për rrjedhim pa efektin e kërkuar integral nga ligji i dekriminalizimit.<sup>4</sup> Për më tepër, partitë joparlamentare, si dhe zonat e largëta elektorale në nivel vendor u bënë strehë e personave të botës së krimit për shkak të vëmendjes së ulët të medias, opinionit publik dhe pragmatizmit politik.

---

<sup>1</sup> Neni 1, Ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kuvendi i Shqipërisë, datë 17.12.2015.

<sup>2</sup> Shiko statistikat e ISP tek <https://dekriminalizimi.isp.com.al/>

<sup>3</sup> ISP. (2024). Integriteti i zyrtarëve të zgjedhur – Raport monitorues për qarqet Kukës, Dibër e Shkodër 2023-2024. <https://isp.com.al/integriteti-i-zyrtareve-te-zgjedhur-raport-monitorues-per-qarqet-kukes-diber-e-shkoder-2023-2024>  
Shiko gjithashtu ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

<sup>4</sup> “Ligji i dekriminalizimit, një dështim!/ Politika ende e inkriminuar edhe pas 7 vitesh”. *Top News*. <https://www.youtube.com/watch?v=gxupyEzARR8>

Kur Shqipëria po i afrohet një dekade nga miratimi i ligjit të dekriminalizimit, sfidat e pastrimit të politikës nga personat me të shkuar kriminale dhe korruptive kanë ndryshuar natyrë dhe formë. Forcimi i institucioneve të drejtësisë, veçanërisht funksionaliteti i plotë i SPAK (Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar) ka ekspozuar gjithnjë e më shumë përfshirjen e zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të lartë në korrupsion dhe lidhjen e funksionarëve të policisë së shtetit dhe politikës me krimin e organizuar. Ndërsa në vitet e para procesi i dekriminalizimit u përqendrua në pastrimin e niveleve të larta të politikës dhe institucioneve të shtetit nga individë të ekspozuar nga media dhe opozita me rekorde kriminale, vitet e fundit me thellimin e reformës në drejtësi ky proces është zgjeruar në të gjitha nivelet dhe sferat e veprimtarisë shtetërore në vend.

Në këtë kontekst SPAK e ka ndihmuar procesin e dekriminalizimit duke hetuar në mënyrë më të sofistikuar dhe të vendosur korrupsionin në nivele të larta dhe krimin e organizuar, duke prodhuar kështu produkte konkrete në procesin e dekriminalizimit.<sup>5</sup> Të paktën dy ish-kryeministra janë nën hetim për korrupsion, njëri është referuar tashmë në gjykatë për gjykim. Disa ish-ministra, kryetarë dhe ish-kryetarë bashkie, si dhe drejtues të lartë në administratë, polici të shtetit dhe sistemin e drejtësisë janë nën hetim, ndërsa një pjesë e çështjeve janë dërguar për gjykim. Në këtë kontekst, SPAK po i paraprin jetësimit integral të parimeve të ligjit të dekriminalizimit, duke dhënë shenja të forta për pastrimin e politikës dhe shtetit nga individët me rekorde korruptive dhe kriminale.

Me gjithë progresin e bërë në këtë drejtim, dekriminalizimi vijon të jetë temë në debatin politik dhe publik, me akuza të ndërsjella dhe retorikë të fortë kundër organeve të reja të drejtësisë. Kur Shqipërinë e ndajnë pak muaj nga zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2025, retorika politike dhe publike rreth dekriminalizimit po bëhet gjithnjë e më e ashpër dhe polarizuese. Pavarësisht sukseseve të organeve të reja të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, shkëputja e shtetit nga ndikimi i individëve me rekorde korruptive dhe kriminale mbetet sfida për institucionet e brishta demokratike të Shqipërisë.

## Dekriminalizimi në nivele të larta

Objektivi kryesor i ligjit të dekriminalizimit është ndarja e politikës nga individët me rekorde korruptive dhe kriminale si parakusht për konsolidimin e demokracisë dhe avancimin e shpejtë të Shqipërisë në rrugën e integritetit evropian. Në raportin vlerësues (screening) të Komisionit Evropian theksohet se pavarësisht reformave dhe kornizës ligjore në tërësi në përputhje me standardet evropiane, Shqipëria vijon të ketë probleme me funksionimin e institucioneve demokratike, llogaridhënien, korrupsionin dhe krimin e organizuar.<sup>6</sup> Në mënyrë të veçantë, raporti

---

<sup>5</sup> Shiko, Performance Assessment: Measuring Effectiveness, Monitoring Progress and Enhancing Accountability of Special Prosecution (SPAK) and Special Courts Against Corruption and Organised Crime (2020-2023) 4th Assessment Report. CSDG. [https://csdgalbania.org/publications/SPAK\\_Report\\_2020-2023\\_ENG.pdf](https://csdgalbania.org/publications/SPAK_Report_2020-2023_ENG.pdf)

<sup>6</sup> European Commission. Screening report, Albania: Cluster 1 – Fundamentals. 2023.

vë në dukje se ligjet shpesh mbeten akte formale në shtypura në letër, pasi gjejnë pak zbatim në praktikë.<sup>7</sup> Prandaj, intensifikimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është me rëndësi jetike për të ardhmen evropiane të Shqipërisë. Në këtë kontekst, kur BE ka rritur përpjekjet për thellimin e reformave integruese në rajonin e Ballkanit si një hap strategjik për zgjerimin e Unionin, Shqipëria ka marrë vëmendje të veçantë në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe kornizës ligjore për thellimin e luftës kundër kulturës së pandëshkueshmërisë dhe krimit të organizuar. Kështu, mbështetja e komunitetit ndërkombëtar ndaj SPAK si agjenci e specializuar për luftën kundër korrupsionit në nivele të larta dhe krimit të organizuar është thelluar.<sup>8</sup>

Funksionaliteti i plotë i SPAK dhe mbështetja ndërkombëtare në mungesë të vullnetit të brendshëm organik nga institucionet shqiptare për të ndihmuar punën e tij, ka vijuar të japë produkte pozitive në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta edhe gjatë gjysmës së parë të vitit 2024. Një numër domethënës zyrtarësh të lartë janë proceduar nga SPAK për përfshirje në akte korruptive ku si pasojë janë dorëhequr nga funksionet publike ose janë nën presionin e medias dhe opinionit publik për t'u larguar nga politika.

SPAK ka mbyllur hetimet për ish-kryeministrin Sali Berisha dhe e ka dërguar çështjen për gjykim në GJKKO.<sup>9</sup> Hetimet ndaj ish-kryeministrit Berisha, i cili është edhe zyrtarisht kryetar i opozitës në Shqipëri, janë shoqëruar me retorikë të ashpër kundër kreut të SPAK dhe polarizim të mëtejshëm të skenës politike. Ish-kryeministri është zyrtari më i lartë në dy dekada i marrë nën hetim për korrupsion dhe proceduar për gjykim. Megjithatë, ish-kryeministri vijon të jetë deputet në Kuvendin e Shqipërisë dhe drejton partinë më të madhe politike në opozitë, duke dëshmuar kështu se standardi i largimit nga politika si pasojë e akuzave mbetet i pazbatueshëm për nivele të larta politike në realitetin shqiptar. Ish-ministri dhe deputeti Lefter Koka, cili akuzohet për *shpërdorim detyre*, është dërguar për gjykim në GJKKO.<sup>10</sup> Ish-ministri Koka u detyrua të largohet nga politika vetëm pak muaj pasi kishte fituar një mandat tjetër deputeti në qarkun e Durrësit në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të vitit 2021 si pasojë e hetimeve intensive të SPAK.

Gjithashtu ish-ministri dhe deputeti Ilir Beqaj, i cili akuzohet për *shpërdorim detyre dhe korrupsion pasiv i zyrtarëve të lartë shtetëror* është dërguar për gjykim.<sup>11</sup> Megjithëse duket se mazhoranca qeverisëse nuk tregoi të njëjtin vullnet për t'u distancuar nga Ilir Beqja kur ky u mor nën hetim siç ka bërë në raste të tjera, SPAK tregoi vendosmëri dhe e vendosi nën akuzë ish-ministrin. Kjo e detyroi të dorëhiqej nga funksionet politike dhe publike që mbante dhe të vendoset nën arrest. Në të njëjtën kohë, ish-zëvendës ministri i Shëndetësisë Klodian Rrepaj është dërguar për gjykim nga

---

<sup>7</sup> Po aty

<sup>8</sup> Fight against organized crime/ SPAK signed a memorandum of understanding with NCA. *ABC News*. 22 Shkurt, 2024. <https://abcnews.al/fight-against-organized-crime-spak-signed-a-memorandum-of-understanding-with-nca/>

<sup>9</sup> Shiko, SPAK mbyll hetimet për 'Partizanin', të mërkurën Berishës dhe Malltezit i jepen aktet e dosjes. *Shqiptarja.com*, 23 shtator 2023. <https://shqiptarja.com/lajm/spak-mbyll-hetimet-per-partizanin-te-merkuren-berishes-dhe-malltezit-i-jepen-aktet-e-dosjes-do-firmosin-nen-akuze-bektashi-begeja-dhe-pustina>

<sup>10</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-02-08-2024/>

<sup>11</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-28-03-2024/>

SPAK.<sup>12</sup> Ai akuzohet për *mashttrim dhe shpërdorim detyre* dhe ka humbur me kohë funksionet publike që mbante si pasojë e procedimit nga SPAK. Vetëm pak kohë më pare deputeti i opozitës, Ervin Saliانji, u dënua nga Gjykata e Apelit për *kallëzim të rremë* duke nxitur kështu humbjen eventuale të mandatit të deputetit nga ligji i dekriminalizimit.<sup>13</sup>

Lufta e SPAK kundër korrupsionit në nivele të larta ka vijuar duke dërguar për gjykim ose thelluar hetimet për disa ish-zyrtarë të tjerë të lartë. Ish-kryetarja e Bashkisë Patos dhe në momentin e gjykimit Prefekti i qarkut Fier është pezulluar nga e drejta e ushtrimit të funksioneve publike si pasojë e *shkeljes së barazisë* në tendera.<sup>14</sup> Ish-kryetari i Bashkisë Himarë vijon të mbetet nën masën arrestit i akuzuar për shpërdorim detyre<sup>15</sup> ndërsa funksionarët e lartë të bashkisë Tiranë janë nën masa arresti dhe po procedohen për *akte korruptive dhe shkelje të barazisë në tendera*.<sup>16</sup> Lufta kundër korrupsionit është shtrirë edhe në radhët e Policisë së Shtetit dhe sistemit të drejtësisë. Ish-drejtuasi i Forcës Operacionale në Policinë e Shtetit është nën arrest, ndërkohë që janë sekuestruar pasuri të tij të dyshuara si pasojë e veprimtarisë korruptive.<sup>17</sup> Ish-shefi i krimeve në Komisaratin nr.6 në Tiranë është dërguar për gjykim, i akuzuar për *përfshirje në veprimtari kriminale* me organizata të krimit të organizuar. Dy gjyqtarë, respektivisht një në Elbasan dhe një në Tiranë janë në procedim për shkelje ligjore, respektivisht për *korruption pasiv dhe kallëzim të rremë dhe falsifikim dokumentesh*.

Thellimi i luftës kundër korrupsionit në nivele të larta është shoqëruar paralel me intensifikimin e veprimtarisë së SPAK kundër krimit të organizuar. Si pasojë një numër i lartë individësh janë arrestuar dhe në dritë kanë dalë lidhjet e politikës me krimin e organizuar.<sup>18</sup> Ish-deputeti Arben Ndoka u arrestua në një nga këto operacione, duke konfirmuar nevojën e ligjit të dekriminalizimit të miratuar në vitin 2015. Ish-nëndrejtori i Policisë së Tiranës është dërguar gjithashtu për gjykim i akuzuar për *pastrim të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale*.<sup>19</sup> Sofistikimi i ndikimit të botës së krimit në politikë pas pastrimit fillestar të politikës nga radhët e individëve me rekorde kriminale e ka bërë shkëputjen e politikës nga influencat e krimit të organizuar një ndërmarrje sfiduese. Prandaj, ekspozimi i lidhjeve të politikës me krimin e organizuar është hap i rëndësishëm në jetësimin integral të ligjit të dekriminalizimit.

---

<sup>12</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-30-03-2024/>

<sup>13</sup> Edmond Hoxhaj, Deputeti demokrat, Ervin Saliانji dënohet me 1 vit burg nga Apeli. *Reporter.al*, 26 shtator 2024. <https://www.reporter.al/2024/09/26/deputeti-demokrat-ervin-saliانji-denohet-me-1-vit-burg-nga-apeli/>

<sup>14</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-09-03-2024/>

<sup>15</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-23-03-2024-2/>

<sup>16</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-28-03-2024/>

<sup>17</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-sekuestrim-pasurie-date-31-01-2024/>

<sup>18</sup> Megaoperacioni i SPAK, GJKKO 43 urdhër arreste! Mes tyre vëllezërit Avdylaj dhe Duka! Në kërkim ish-deputeti i PS, dhe nipi, pranga të afërmit të Pëllumb Gjokës. *Top Channel*, 18 maj 2024. <https://top-channel.tv/2024/05/18/emrat-megaoperacioni-i-spak-gjkkko-43-urdher-arreste-mes-tyre-vellezërit-avdylaj-dhe-duka-ne-kerkim-ish-deputeti-i-ps-dhe-nipi-pranga-te-afërmit-te-pëllumb-gjokës/>

<sup>19</sup> SPAK, Njoftim. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-07-08-2024/>



## Dekriminalizimi në nivele të mesme dhe të ulëta

Pastrimi i politikës nga individët me të shkuar kriminale apo të përfshirë në korrupsion në nivele të larta ishte shtyja kryesore e miratimit të ligjit të dekriminalizimit në vitin 2015. Prezenca e hapur e personave me rekorde kriminale dhe korruptive në institucionet e larta të shtetit, si Kuvendi i Shqipërisë, parti politike, nivele ekzekutive dhe institucione të tjera kushtetuese ngriti alarmin e kapjes së shtetit nga bota e krimit në rrethet publike në Shqipëri dhe në kancelaritë perëndimore të angazhuara me procesin e demokratizimit dhe integritetit të Shqipërisë në BE. Në këtë kuptim, vëmendja kryesore u përqendrua në pastrimin e politikës në nivele të larta dhe ndalimin e kandidimit apo marrjes së detyrës nga individët e papërshtatshëm. Megjithatë, ligji i dekriminalizimit u hartua me një qëllim më integral dhe gjithëpërfshirës, duke bërë objekt edhe funksionarët e mesëm dhe të ulët në një përpjekje radikale për reformimin e thellë të sistemit politik dhe administratës publike në Shqipëri.

Por, kur ka kaluar pothuajse një dekadë nga miratimi i ligjit, dekriminalizimi në nivele drejtuese dhe administrative ka marrë më pak vëmendje nga opinioni publik. Një pjesë e mirë e individëve të korruptuar apo me të shkuar kriminale filluan të gjejnë strehë në funksione të padukshme në makinerinë e shtetit për të mos u bërë pre e ligjit të dekriminalizimit. Ndërkohë, vetëdija e ulët demokratike, klientelizmi dhe rrjetet e patronazhit kanë mundësuar depërtimin e personave me të shkuar kriminale dhe rekorde korruptive në administratën shtetërore.

Gjithsesi, njëfarë progresi është bërë edhe në këtë drejtim. Nga raportimet e ISP në të shkuarën është vënë re se si qindra këshilltarë vendorë kanë rënë në rrjetën e dekriminalizimit.<sup>20</sup> Disa prej tyre janë larguar pas verifikimeve të KQZ në bashkëpunim me organet ligjzbatuese si Prokuroria e Përgjithshme, ndërsa të tjerë janë dorëhequr pas presioneve politike dhe medias. Në gjysmën e parë të vitit 2024 organet ligjzbatuese kanë proceduar për vepra penale të ndryshme një numër të lartë zyrtarësh. Vetëm Prokuroria e Përgjithshme ka proceduar rreth 117 raste duke përfshirë një numër të lartë funksionarësh të Policisë së Shtetit, organeve të qeverisjes vendore dhe administratës publike. Vetë Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (AMP), një mekanizëm mbikëqyrës dhe kontrollues i veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe Gardës së Republikës ka marrë masa pezullimi, pushimi nga puna apo ka referuar në prokurori për hetime të mëtejshme ndaj rreth 80 funksionarëve në Polici.

Numri i lartë i punonjësve të Policisë, 37 procedime në total nga Prokuroria dhe 80 nga AMP, tregon për nevojën e masave parandaluese, si verifikimet paraprake më të rregulluara, forcimin e kontrollit të brendshëm nëpërmjet AMP dhe rritjen e profesionalizmit të trupës policore. Ndërkohë, vetë Policia e Shtetit ka proceduar për vepra të ndryshme penale, si korrupsion, shpërdorim detyre apo përfshirje në veprimtari kriminale rreth 130 funksionarë të mesëm dhe të ulët në disa agjenci shtetërore, administratë publike dhe njësi të qeverisjes vendore.

---

<sup>20</sup> Shiko raportin e ISP, Decriminalization and Integrity: Report with Findings and Recommendations 2021-2023. <https://dekriminalizimi-isp-com-al.translate.goog/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

Këto shifra të larta për një vend relativisht të vogël si Shqipëria, që synon të bëhet anëtare e BE në një periudhë të shkurtër, dëshmojnë për nevojën e shtrirjes së ligjit të dekriminalizimit në të gjitha hallkat e qeverisjes dhe administratës publike. Procedimet dhe vendimet e gjykatave të vendit do të shtrijnë veprimin e parimeve të dekriminalizimit edhe në këto nivele, por kjo do të kërkojë kohë, vullnet dhe vëmendje më të shtuar të medias dhe shoqërisë civile për të advokuar një jetësim më gjithëpërfshirës të ligjit. Prandaj, është me rëndësi që procesit t'i paraprihet me akte rregullatore më efikase, masa parandaluese dhe verifikuese më të forta, dhe ndarje të administratës publike nga ndikimi klientelist dhe politik.

## Sfidat e dekriminalizimit

Pavarësisht progresit në procesin e dekriminalizimit të politikës dhe institucioneve shtetërore, jetësimi gjithëpërfshirës i parimeve të dekriminalizimit mbart akoma plot sfida.

Së pari, partitë politike dhe institucionet shtetërore në tërësi kanë bërë pak për integrimin konkret të praktikave parandaluese, duke mos garantuar kandidatë apo funksionarë politikë dhe publikë me integritet. Interesat e ngushta politike, kapitalizimi i lidhjeve informale me botën e krimit dhe individët e korruptuar për interesa elektorale, klientelizmi dhe sistemi i patronazhit në emërimin e funksionarëve publikë ka penguar jetësimin e praktikave të mira parandaluese në jetën politike dhe shtetërore. Kështu, vullneti politik për të garantuar funksionarë të zgjedhur dhe emëruar në pozita të larta shtetërore mungon.

Së dyti, procedimi dhe rënia eventuale në rrjetën e dekriminalizimit të zyrtarëve të niveleve të larta ka ashpërsuar retorikën politike kundër institucioneve të drejtësisë. Kreu i SPAK është sulmuar nominalisht nga politikanë të lartë në vend, të cilët janë vendosur nën hetim apo masa sigurie nga SPAK si të dyshuar për korrupsion.<sup>21</sup> Intensifikimi i retorikës kundër SPAK sinjalizon se do të ketë rezistencë ndaj efekteve të ligjit të dekriminalizimit në rast masash gjyqësore ndaj politikanëve me ndikim në jetë e vendit.

Së treti, goditja e kulturës së pandëshkueshmërisë në nivele të larta ka nxitur përpjekje për të minuar punën e SPAK dhe institucioneve të reja të drejtësisë në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta. Në prill 2024 Kuvendi miratoi me votë pothuajse bipartizane një amnisti penale, e cila lehtësoi dënimet e disa zyrtarëve për korrupsion, duke goditur punën e institucioneve të drejtësisë në këtë drejtim.<sup>22</sup> Veprime të tilla pengojnë thellimin e procesit të dekriminalizimit dhe

---

<sup>21</sup> SPAK mbylli hetimet për “Partizanin”, Berisha sulmon prokurorët dhe Dumanin. *Top Channel*, 25 shtator 2024. <https://top-channel.tv/2024/09/25/spak-mbylli-hetimet-per-partizanin-berisha-sulmon-prokuroret-dhe-dumanin-ndrikulla-e-rrezikshme-e-bandave-dhe-xhelati-i-policise-sekrete/> Shiko: Nën hetim së bashku me bashkëshorten për pasurinë, Meta sulmon sërish Dumanin: SPAK, parti e paligjshme prokurorësh. *Top Channel*, 17 qershor 2024. <https://top-channel.tv/2024/06/17/nen-hetim-se-bashku-me-bashkeshorten-per-pasurine-meta-sulmon-serish-dumanin-spak-parti-e-paligjshme-prokuroresh/>

<sup>22</sup> Shiko, Miratohet Amnistia Penale me 110 vota pro, 1 abstenim dhe 1 kundër. Përfitojnë ish-drejtorë e funksionarë të dënuar nga GJKKO, 700 të burgosur lirohen menjëherë. *Top Channel*, 4 prill 2024. <https://top->

minojnë shtetin e së drejtës dhe funksionimin demokratik të institucioneve. Në kuadër të kësaj përpjekjeje duket edhe nisma e fundit në Kuvendin e Shqipërisë ku është ngritur një *komision i posaçëm për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit*. Nisma ka ngjallur debate të shumta dhe ka shqetësime serioze që ajo synon reduktimin e fushës së veprimit dhe pavarësisë së institucioneve të drejtësisë.<sup>23</sup> Së fundi, delegacioni i BE në Tiranë ka nënvizuar se pavarësia e sistemit të drejtësisë nuk mund të jetë objekt i punës së institucioneve të tjera.<sup>24</sup>

Akte të tilla tregojnë se Shqipëria ka rrugë të gjatë përpara në implementimin tërësor të parimeve të ligjit të dekriminalizimit. Forma të reja të rezistencës janë në veprim, ndërsa kultura e dobët demokratike dhe institucionale rrezikon ta kthejë dekriminalizimin në një punë të pambaruar për një periudhë të gjatë kohe.

---

[channel.tv/2024/04/04/miratohet-amnistia-penale-me-110-vota-pro-l-abstenim-dhe-l-kunder-perfitojne-ish-drejto-re-e-funksionare-te-denuar-nga-gjikko-700-te-burgosur-lirohen-menjehere/](https://www.zeriamerikes.com/a/7609270.html?sfnsn=scëspëa)

<sup>23</sup> Nisma e PS, Delegacioni i BE-së: Të mos preket reforma në Drejtësi. *Zeri Amerikes*, 13 maj 2024.

<https://www.zeriamerikes.com/a/7609270.html?sfnsn=scëspëa>

<sup>24</sup> Ambasadori Gonzato: “Pa institucione të pavarura të drejtësisë nuk ka drejtësi të pavarur”. *Zeri Amerikes*, 26 shtator 2024.

[https://www.zeriamerikes.com/a/7799889.html?fbclid=IëY2xjaëFiG3dleHRuA2FlbQIxMQABHëGXy0DUQGBlS C152f\\_63EZ8LYq3rZ1cmë8NJatDtNGqTrBRalëEKV-eBg\\_aem\\_QkoKXt1q9mMqZYQubJzyjë&sfnsn=scëspëa](https://www.zeriamerikes.com/a/7799889.html?fbclid=IëY2xjaëFiG3dleHRuA2FlbQIxMQABHëGXy0DUQGBlS C152f_63EZ8LYq3rZ1cmë8NJatDtNGqTrBRalëEKV-eBg_aem_QkoKXt1q9mMqZYQubJzyjë&sfnsn=scëspëa)